



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

*Komisioni hetimor “Për kontrollin e veprimtarisë së organeve të administratës publike dhe pushtetit vendor, për të verifikuar përdorimin e burimeve të administratës shtetërore për qëllime elektorale në zgjedhjet e 25 prillit 2021”*

### PROCESVERBAL

Tiranë, më datë 29.10.2021, ora 10:00

**Drejton mbledhjen:**

**Enkelejd Alibeaj – kryetar i Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit të datave 18.10.2021 dhe 22.10.2021.
2. Njoftime
3. Vazhdimi i shqyrtimit të Rregullores së brendshme të funksionimit të Komisionit Hetimor.
4. Zgjedhja e Sekretarit të Komisionit.
5. Caktimi i mbledhjes së ardhshme të Komisionit.

#### **Marrin pjesë:**

Enkelejd Alibeaj, Toni Gogu, Blerina Gjylameti, Klevis Xhoxhi, Nasip Naço, Petro Koçi, Bardhyl Kollçaku, Gazment Bardhi, Oerd Bylykbashi, Ferdinant Xhaferraj, Ervin Salianji, Kreshnik Çollaku, Petrit Vasili, Xhemal Qefalia dhe Etjen Xhafaj.

#### **Mungojnë:**

Klotilda Bushka dhe Aurora Mara.

## HAPET MBLEDHJA

**Enkelejd Alibeaj** – Mirëmëngjesi, kolegë!

Çelimi mbledhjen e ditës së sotme, të caktuar që në mbledhjen e kaluar. Nga verifikimi fizik, po edhe ai i bërë së bashku me sekretarinë, rezulton që kuorumi i mbledhjes është. Për këtë arsye mund të fusni edhe mediet dhe të fillojmë pastaj nga mbledhja.

Nëse media është gati, ne mund të procedojmë me vazhdimin e mbledhjes. Me sa shoh, edhe gazetarët janë prezentë, edhe kameramanët po vrapojnë për t'u pozicionuar. Ne do të fillojmë, ndërkohë.

Mirëmëngjesi edhe një herë!

Çelimi mbledhjen e sotme, e cila ka për rend dite të caktuar në mbledhjen e kaluar, si pikë të parë, miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të kaluara të komisionit; si pikë të dytë janë njoftimet, si pikë të tretë kemi vazhdimin e shqyrtimit të rregullores së brendshme të funksionimit të komisionit hetimor, e katërta pikë është zgjedhja e sekretarit të komisionit dhe e pesta, si detyrim ligjor, është caktimi i mbledhjes së ardhshme të komisionit.

Lidhur me procesverbalet, pas konsultimit me sekretarinë e komisionit, ato janë zbardhur. Në pritje edhe të zbardhjes së mbledhjes paraardhëse, sipas edhe premtimit, ato do të zbardhen dhe pastaj do të nënshkruhen nga ana e përfaqësuesit të komisionit, kryetari, eventualisht sekretari, zëvendëskryetari në mbledhjen tjetër.

Pika e dytë e rendit të ditës ka të bëjë me njoftime.

Për sqarimin tuaj, në bazë edhe të të drejtave që kanë anëtarët e komisionit, si edhe në mbledhjen e kaluar, ku u depozituan një sërë kërkesash, gjithmonë në bazë të planit paraprak hetimor, sipas të cilit dhe në bazë të ligjit, secili deputet ka të drejtë të ofrojë, të servirë në komision të dhëna të mbledhura në rrugë zyrtare ose jo, të cilat do të jenë lënda për t'u verifikuar dhe për t'u administruar në fazën tjetër të komisionit, pas miratimit të planit paraprak hetimor. Një pjesë e deputetëve kanë bërë një sërë kërkesash. Thjesht për efekt dokumentimi, më duhet t'i listoj cilat ato janë. Të gjitha këto kërkesa do të administrohen nga sekretaria dhe janë të tilla: kërkesë për informacion drejtuar drejtorit të Përgjithshëm të Rezervave të Materialeve të Shtetit, zotit Sokol Zaimi, me anë të së cilës kërkohet një informacion (e dhënë) i plotë, i detajuar lidhur me gjendjen e rezervave të shtetit në depozitat qendrore dhe lokale për çdo muaj në periudhën 1 janar 2020-30 prill 2021.

Një tjetër kërkesë i drejtohet drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimeve Publike, në bazë të së cilës për të njëjtën periudhë kërkohet: 1. Sa është numri i tenderëve, koncesioneve, PPP-ve të shpallura apo për të cilat fituesi është shpallur në periudhën 1 janar 2020-30 prill 2021, i ndarë sipas muajve; 2. Sa është vlera totale e fondit limit për procedurat e mësipërme për secilin muaj gjatë periudhës 1 janar 2020-30 prill 2021; 3. Sa është vlera totale e ofertave të shpallura fituese për secilin muaj gjatë periudhës, gjithmonë 1 janar 2020-30 prill 2021.

Një tjetër kërkesë i drejtohet kryetarit të Këshillit Kombëtar të Territorit, Kryeministrit Edi Rama, me anë të së cilës kërkohet: 1. Sa është numri i lejeve të ndërtimit që janë dhënë për periudhën 1 janar 2020-30 prill 2021, i ndarë sipas muajve të kësaj periudhe dhe për secilën njësi vendore dhe, e dyta, sa është numri i hapësirës në metra katrorë që këto leje zënë sipas bashkive, leje të cilat janë dhënë për periudhën e mësipërme.

Një tjetër kërkesë është ajo e cila i drejtohet zotit Arben Ahmetaj, ministër i Shtetit për Rindërtimin, me anën të së cilës kërkohet: 1. Sa është numri i banesave të ndërtuara, të rindërtuara, për të cilat është bërë dorëzimi gjatë periudhës 1 janar 2020-30 prill 2021, të ndara këto sipas secilit muaj të kësaj periudhe dhe në secilën bashki, 2. Sa është numri i familjeve që janë prekur nga tërmeti dhe që kanë përfituar dëmshpërblim gjatë periudhës 1 janar 2020-30 prill 2021, edhe këto të ndara sipas secilit muaj të kësaj periudhe, dhe në fund sa është masa e shpërblimit për këto familje.

Një tjetër kërkesë është ajo drejtuar zotit Artan Lame, drejtor i Përgjithshëm i Kadastrës, me anë të së cilës kërkohet informacion lidhur me: 1. Sa është numri i lejeve të legalizimit të dhëna përgjatë periudhës 1 janar 2020-30 prill 2021, të ndara sipas secilit muaj të kësaj periudhe, 2. Sa është numri i certifikatave të pronësisë të dhëna gjatë periudhës 1 janar 2020-30 prill 2021, të ndara sipas secilit muaj të së njëjtës periudhë.

Tjetër kërkesë është ajo që i drejtohet të 61 bashkive të Republikës, me anë të të cilës u kërkohen të dhëna në këto drejtime:

1. Sa ka qenë numri i të punësuarve pranë bashkisë, respektive, institucioneve të saj të varësisë, përfshirë edhe shoqëritë në pronësi për periudhën 1 janar 2020 - 30 prill 2021, e ndarë kjo sipas secilit muaj?

2. Sa është numri i të punësuarve pranë bashkisë, institucioneve të varësisë, përfshirë edhe shoqëritë në pronësi për periudhën 1 janar 2020- 30 prill 2021?

3. A është rritur dhe sa është fondi i pagave për bashkinë dhe të gjitha njësitë administrative për të njëjtën periudhë, e ndarë sipas çdo muaji?

4. A ka pasur rritje të pagave ndaj punonjësve të bashkisë, institucioneve të saj të varësisë, përfshirë edhe shoqëritë në pronësi të tyre? Nëse po, në çfarë mase është rritur paga për secilën kategori punëmarrësish dhe sa punonjës kanë përfituar nga kjo rritje?

5. A ka pasur shtesa apo shpërblime ndaj punonjësve të bashkisë, institucioneve të saj të varësisë, përfshirë edhe shoqëritë në pronësi të tyre? Nëse po, në çfarë mase kanë qenë këto shpërblime për secilën kategori punëmarrësish dhe sa punonjës kanë përfituar nga shtesat apo shpërblimet?

6. Sa persona kanë përfituar ndihmë ekonomike për periudhën 1 janar 2020 -30 prill 2021, të ndarë sipas secilit muaj të kësaj periudhe?

7. A kanë qenë të gjithë përfituesit e ndihmës ekonomike në Shqipëri gjatë periudhës së përfitimit të saj?

8. Sa është numri i lejeve të ndërtimit që janë dhënë për periudhën e mësipërme 1 janar 2020 -30 prill 2021, e ndarë edhe kjo për çdo muaj?

9. Sa është numri i hapësirës në metra katrorë që këto leje ndërtimi zënë, sipas bashkive në të cilat janë dhënë lejet për të njëjtën periudhë?

Tjetër kërkesë, drejtuar zotit Bledar Doracaj, drejtor i Përgjithshëm i Gjendjes Civile, me anë të së cilës kërkohet:

1. Sa është numri i shtetasve shqiptarë që kanë ndryshuar adresën e banimit në periudhën 1 janar 2020 - 30 prill 2021?

2. Cilat janë kompanitë e nënkontraktuara në 5 vjetët e fundit nga 1 janari 2015 - 31 dhjetor 2020 për mirëmbajtjen e bazës të të dhënave të gjendjes civile? Ndërkohë, kërkohet që emrat e kompanive të shoqërohen me të dhënat kryesore të marrëdhënieve kontraktore që kanë ekzistuar me këto kompani.

3. A ka pasur ndonjë apo disa raste, ku janë vërejtur incidente në bazën e të dhënave që administrohen nga institucioni juaj, të tilla si, por pa u kufizuar në rrjedhje të të dhënave, hyrje të paautorizuara pa cenime të tjera të parametrave të sigurisë?

4. A ka pasur ndonjë apo disa raste kur institucioni juaj, gjithmonë Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, zyrtarisht ose informalisht i ka vënë në dispozicion këto të dhëna personale (bëhet gjithmonë fjalë për patronazhistët) të këtyre personave apo personave të lidhur

me të, nga ata që administrojnë nga institucioni juaj? Nëse po, kërkohet të shpjegohen në mënyrë të detajuar rastet që kanë ndodhur, nëse kanë ndodhur.

Tjetër kërkesë është ajo që i drejtohet zonjës Albana Koçiu, drejtore e Përgjithshme e Departamentit të Administratës Publike, me anë të së cilës i kërkohet: sa është numri i punonjëseve në administratën publike qendrore dhe vendore për periudhën 1 janar 2020-30 prill 2021, e ndarë kjo për secilin muaj të kësaj periudhe? Për administratën publike vendore sa është numri i punonjësve në secilin qark dhe secilën bashki?

Tjetër kërkesë, drejtuar bashkive Durrës, Shijak, Krujë, Lezhë, Mirditë, Kurbin, Tiranë, Kamëz, Vorë, Kavajë dhe Rrogozhinë. Këtyre bashkive u kërkohet:

1. Sa është numri i banesave të ndërtuara apo të rindërtuara për të cilat është bërë dorëzimi i banesave gjatë periudhës 1 janar 2020 -30 prill 2021, të ndara sipas secilit muaj të kësaj periudhe dhe në secilën bashki?

2. Sa është numri i familjeve që janë prekur nga tërmeti dhe që kanë përfituar dëmshpërblim gjatë periudhës 1 janar 2020-30 prill 2021, të ndara sipas secilit muaj të kësaj periudhe dhe në secilën bashki dhe sa është masa e shpërblimit për këto familje?

Tjetër kërkesë është ajo që i adresohet Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike OSHE-, Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare KESH, Operatorit të Sistemit të Transmetimit OST dhe Postës Shqiptare, lënda e kërkesës është si vijon:

1. Sa është numri i punonjësve për periudhën 1 janar 2020-30 prill 2021, e ndarë sipas secilit muaj?

2. Sa është numri i punonjësve të rinj të punësuar në periudhën 1 janar 2020 - 30 prill 2021, e ndarë sipas secilit muaj?

3. A është rritur paga e punonjësve në periudhën 1 janar 2020-30 prill 2021? Nëse po, në çfarë mase, cilat kategori kanë përfituar nga rritja dhe sa është numri i punonjësve që kanë përfituar rritjen në pagë? Me çfarë akti është miratuar rritja, nëse ka ndodhur një gjë e tillë?

4. A kanë përfituar punonjësit e shoqërisë shpërblime apo shtesa mbi pagën, gjatë periudhës 1 janar 2020-30 prill 2021? Nëse po, në çfarë mase, cilat kategori dhe sa është numri i punonjësve që kanë përfituar shpërblime apo shtesa mbi pagën përgjatë kësaj periudhe? Me çfarë akti është miratuar shpërblimi apo shtesa mbi pagën?

Tjetër kërkesë është ajo që i drejtohet zonjës Ogerta Manastirliu, ministre Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me anë të së cilës kërkohet:

1. Sa është numri i personave apo familjeve që kanë përfituar ndihmë ekonomike përgjatë periudhës 1 janar 2020 - 30 prill 2021, të ndara sipas secilit muaj të kësaj periudhe dhe për secilën bashki?

2. Sa është numri i personave, familjeve, që kanë hyrë në skemën e ndihmës ekonomike për herë të parë përgjatë periudhës 1 janar 2020 - 30 prill 2021, të ndara sipas secilit muaj të kësaj periudhe dhe për secilën bashki?

3. A është rritur masa e përfitimit të ndihmës ekonomike për familjet përfituese përgjatë periudhës së mësipërme, e ndarë kjo sipas secilit muaj të kësaj periudhe dhe për secilën bashki? Nëse po, sa familje kanë përfituar nga rritja e masës dhe me cilin akt është miratuar rritja?

Një kërkesë tjetër i është drejtuar zonjës Mirlinda Kaçanaj, Agjencia Kombëtare e Shërbimit të Informacionit, AKSHI, me anë të së cilës kërkohet informacion se cilat janë kompanitë e nënkontraktuara në 5 vjetët e fundit, në periudhën 1 janar 2015-31 dhjetor 2020, për mirëmbajtjen e bazës së të dhënave të Gjendjes Civile? Ju lutem, emrat e kompanive të shoqërohen me të dhënat kryesore të marrëdhënieve kontraktore që kanë ekzistuar këto kompani.

A ka pasur ndonjë apo disa raste kur janë vërejtur incidente me bazën e të dhënave që administrohen nga institucioni juaj, të tilla si, por pa u kufizuar në: rrjedhje të të dhënave, hyrje të paautorizuara apo cenime të tjera të parametrave të sigurisë?

A ka pasur ndonjë apo disa raste kur institucioni juaj zyrtarisht ose informalisht ua ka vënë në dispozicion këto të dhëna personave të paautorizuar nga ato që administrohen nga institucioni juaj? Nëse po, ju lutem shpjegoni në mënyrë të detajuar rastet se kur ka ndodhur.

Një kërkesë tjetër i është drejtuar zotit Besnik Dervishi, Komisioner për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me anë të cilës, bazuar në nenin 13, pika 4, neni 14, germa b, të ligjit “Për komisionet hetimore”, kërkohet vënien në dispozicion të praktikës së plotë të ndjekur prej zyrës së tij për rastin e publikimit të të dhënave personale të 910 000 qytetarëve të Tiranës. Në këtë rast bëhet fjalë për patronazhistët.

Një kërkesë tjetër i është drejtuar zotit Bledar Çuçi, ministër i Brendshëm, me anë të së cilës kërkohet informacion i plotë dhe i detajuar lidhur me numrin e shqiptarëve me të drejtë vote që jetojnë jashtë Shqipërisë, veçanërisht atyre që jetojnë në Greqi dhe Maqedoninë e Veriut.

Një kërkesë tjetër i është drejtuar zotit Helidon Bendo, Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimit të Shtetit, me anë të së cilës kërkohen këto informacione:

Gjatë veprimtarisë suaj a janë konstatuar raste të personave të dyshuar si të përfshirë në krime zgjedhore?

A ka përcjellë institucioni juaj pranë organeve ligjzbatuese informacione lidhur me dyshime të arsyeshme për persona të përfshirë në krime zgjedhore? Sa është numri total i informacioneve të përcjella për këtë çështje, nëse ka?

Gjatë veprimtarisë së Shërbimit Informativ Shtetëror ndaj elementeve të krimit të organizuar a janë konstatuar raste të përfshirjes së tyre në krime zgjedhore apo në fushatë zgjedhore? A janë informuar organet ligjzbatuese lidhur me këto raste? Sa është numri i tyre?

Sa është numri total i informacioneve të trajtuara dhe përpunuara nga institucioni juaj, që përfshijnë dyshime për angazhim në krime zgjedhore, i ndarë sipas secilit qark?

Një kërkesë tjetër i është drejtuar zonjës Frida Krifca, ministre e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, me anë të së cilës kërkohet vënia në dispozicion e një informacioni të detajuar mbi numrin, vlerën e rimbursimeve, tollonave të karburanteve, të dhëna fermerëve për periudhën 01.01.2020 – 30.04.2021, e ndarë kjo sipas muajve respektivë.

Një kërkesë tjetër i është drejtuar Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Kulturës, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, me anë të së cilës u kërkohet:

Sa është numri i punonjësve të ministrisë, institucioneve të saj të varësisë, përfshirë edhe shoqëritë ku ministria ka pronësinë, për periudhën e mësipërme 1. 1. 2020 – 30. 4. 2021, e ndarë kjo sipas secilit muaj të kësaj periudhe?

Sa është numri i punonjësve të rinj të ministrisë, institucioneve të saj të varësisë, përfshirë edhe shoqëritë ku ministria respektive ka pronësinë, për periudhën 1. 1. 2020 - 30. 4. 2021, e ndarë sipas muajve respektivë?

A është rritur paga e punonjësve të ministrisë, institucioneve të saj të varësisë, përfshirë edhe shoqëritë ku ministria ka pronësinë, për të njëjtën periudhë? Nëse po, në çfarë mase, cilat

kategori kanë përfituar nga rritja dhe sa është numri i punonjësve që kanë përfituar rritje në pagë? Me çfarë akti është miratuar rritja e pagës eventuale?

A kanë përfituar punonjësit e ministrisë, institucioneve të saj të varësisë, përfshirë edhe shoqëritë ku ministria ka pronësinë, shpërblime apo shtesa mbi pagën përgjatë periudhës 1. 1. 2020 - 30. 4. 2021? Nëse po, në çfarë mase, cilat kategori dhe sa është numri i punonjësve që kanë përfituar shpërblime apo shtesa mbi pagën përgjatë kësaj periudhe? Me çfarë akti është miratuar shpërblimi apo shtesa mbi pagën?

Një tjetër kërkesë është drejtuar drejtuesit të Prokurorisë Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, zotit Arben Kraja, me anë të së cilës kërkohet të dihet sa është numri i kallëzimeve penale të depozituara pranë kësaj prokurorie lidhur me krimet zgjedhore? Sa është numri i procedimeve penale të regjistruara lidhur me krimet zgjedhore dhe në çfarë faze ndodhen hetimet lidhur me to? Në çfarë faze ndodhen hetimet lidhur me publikimin e të dhënave personale të 910 000 qytetarëve të Tiranës?

Kërkesa e parafundit i është drejtuar Inspektoratit Qendror; Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore; Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit; Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor; Autoritetit Kombëtar të Ushqimit; Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar; Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit; Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut; Autoritetit Kombëtar për Siguri dhe Emergjencat në Miniera; Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore; Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial, me anë të së cilës u kërkohet informacion lidhur me këto çështje:

Sa ka qenë numri i të punësuarve pranë institucionit dhe pranë institucioneve vendore, inspektorateve apo drejtorive vendore gjatë periudhës 1 janar 2020-30 prill 2021, e ndarë sipas muajve? A ka pasur rritje të rrogës ndaj punonjësve të institucionit tuaj dhe pranë institucioneve vendore? Nëse po, në çfarë mase është rritur paga për secilën kategori punëmarrësish dhe sa punonjës kanë përfituar nga kjo rritje?

Së treti, a ka pasur shtesa për shpërblimet ndaj punonjësve të institucionit tuaj dhe pranë institucioneve vendore? Nëse po, në çfarë mase kanë qenë këto shpërblime për secilën kategori punëmarrësish dhe sa punonjës kanë përfituar nga shtesat apo shpërblimet?

Së katërti, sa është numri i inspektimeve të kryera në rang kombëtar gjatë periudhës 1 janar 2020-30 prill 2021, e ndarë sipas muajve?



Së pesti, sa është numri i masave administrative të marra ndaj subjekteve të inspektimit në rang kombëtar gjatë periudhës 1 janar 2020-30 prill 2021, e ndarë sipas muajve?

Së gjashti, sa është numri i inspektimeve të kryera dhe i masave të marra në secilin qark për periudhën 1 janar 2020 -30 prill 2021, e ndarë sipas muajve?

Së shtati, për përgjigjet pyetjeve, sa më sipër, të saktësohet edhe fakti:

a. Nëse inspektimet janë bërë nga inspektoratet vendore apo nga institucioni juaj, qendrori.

b. Sa është numri i masave administrative të revokuara me vendim administrativ apo gjyqësor?

c. Sa është numri i çështjeve gjyqësore me objekt shfuqizimin apo revokimin e masave administrative të dhëna gjatë e periudhës 1 janar 2020 -30 prill 2021, e ndarë sipas muajve, të cilat janë ende në gjykim dhe për të cilat nuk ka ende një vendim të formës?

Kërkesë, drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm, zotit Olsian Çela, me anë të së cilës kërkohet:

1. Sa është numri i kallëzimeve penale të depozituara pranë prokurorive të rretheve gjyqësore në lidhje me krimet zgjedhor?

2. Sa është numri i procedimeve penale të regjistruara në lidhje me krimet zgjedhore dhe në çfarë faza ndodhen hetimet në lidhje me to?

Kërkesa e fundit është drejtuar drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, zotit Gledis Nano, me anë të së cilës kërkohet:

1 Sa është numri i shtetasve të ndaluar, të arrestuar dhe që janë referuar pranë organit të akuzës për krime zgjedhore në rang kombëtar dhe për secilin qark?

2 Sa është numri i shtetasve shqiptarë që kanë hyrë në territorin Republikës së Shqipërisë nga Republika e Greqisë dhe nga Republika e Maqedonisë së Veriut në periudhën 19 prill 2021 -25 prill 2021? Gjithashtu, kërkohet të na vendoset në dispozicion lista e plotë e këtyre e personave.

Pra, këto janë kërkesat për informacion, drejtuar institucioneve shtetërore, të bëra në bazë të ligjit për komisionet hetimore gjatë fazës së realizimit ose plotësimit të planit hetimor paraprak. Për dijeninë tuaj, ju shpjegoj që në këtë fazë të planit të hetimit paraprak secili deputet ka të drejtën të sjellë:

Së pari, të dhëna të mbledhura në mënyrë jozyrtare, por që janë bërë publike.

Së dyti, ka të drejtën të bëjë kërkesën për informacione të tilla, siç ishin këto, me qëllim e vetëm që atë plan hetimor paraprak, objektin e hetimit, ta pasurojë me lëndë apo tema të tjera hetimi, duke u qëndruar strikt katër drejtimeve të objektit të hetimit. Janë kërkesa, të cilat do të administrohen.

Të mos harroj që në seancën e kaluar zoti Vasili paraqiti dhe depozitoi një sërë kërkesash të administruara pranë sekretarisë. E drejta për të paraqitur kërkesa me këtë lëndë, për të sjellë dokumente zyrtare ose jo u takon të gjithë deputetëve të komisionit deri në datën 14 nëntor që, sipas kalendarit të parashikuar në planin e hetimit paraprak, është i përcaktuar si momenti final për t'i plotësuar këto të dhëna, sepse në datën 14 nëntor është paracaktuar që do të jetë miratimi i planit të hetimit.

Të nderuar kolegë,

Ky ishte përshkrimi i kërkesave për t'ua bërë të njohur të gjithë kolegëve dhe publikut. Me kaq e konsideroj të ezauruar këtë pikë të rendit të ditës.

Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës.

Zoti Gogu, keni fjalën.

**Toni Gogu** – Faleminderit, zoti kryetar!

Kam një ndërhyrje për procedurë.

Në mbledhjen e kaluar ne u bëmë një ftesë vetes, juve dhe gjithë këtij komisionit për ta drejtuar veprimtarinë me maturi dhe e vlerësojmë shumë dhe kemi ardhur sot për të dhënë shembullin e të drejtuarit të komisionit me maturi, por vazhdojmë dhe përsëritim kërkesën tonë që ky komision disponon me votim. Në pikën e parë të rendit të ditës ju keni paraqitur në rendin e ditës, që kemi dakordësuar së bashku: miratimin e procesverbaleve të mbledhje së komisionit. Kjo gjë nuk ndodhi për arsye të mbarëvajtjes së mbledhjes dhe të procesverbalit. Dua që kjo të evidentohet në procesverbal dhe ndoshta në një moment caktuar, që ju e shikoni të arsyeshme, ta mund ta hidhni në votim miratimin e procesverbaleve.

Komisioni u njoh me kërkesat, që ju keni i paraqitur këtij komisioni për informacion zyrtar. Gjithashtu, ju informoj se, edhe në vijim të asaj që ju prezantuat, interpretuat dhe sqaruat, ne në mbledhjen e ardhshme do të paraqesim kërkesat tona dhe do ta njohim komisionin me kërkesat tona për informacionin të caktuar që do të donim të bëhej pjesë e planit paraprak të hetimit, para se ne ta votojmë atë.

Faleminderit!

**Enkelejd Alibeaj** – Faleminderit, zoti Gogu!

Është e drejtë kërkesa juaj në lidhje me miratimin e procesverbaleve. Normal që ato do t'i nënshtrohen edhe procedurës së konsultimit dhe të votimit. Unë jo më kot në fillim të mbledhjes e bëra të ditur se deri tani kemi dy procesverbale të mbledhjeve të para, t'i quajmë, që janë të zbardhura. Në emër edhe të sekretarisë, unë ju kërkoj ndjesë, për shkak se kanë qenë të ngarkuar, kemi pasur edhe seancën plenare dhe administrata, por edhe e gjithë pjesa e zbardhjes dhe e redaktimit të procesverbaleve të këtyre mbledhjeve që janë masive, mora premtimin që në mbledhjen e ardhshme do t'i kemi të gjitha dhe si pikë e parë e rendit të ditës do të jetë konsultimi dhe votimi i të gjitha procesverbaleve *on block* që thotë sekretarja.

Sigurisht, ajo se çfarë unë deklarova pak më parë ishte thjesht dhe vetëm një shpalosje e kërkesave të bëra nga një pjesë e deputetëve. E kanë këtë të drejtë të gjithë deputetët, madje jo vetëm në një moment të caktuar, por që sot do të jetë deri në datën 14 nëntor. Kështu që, në mbledhjen e ardhshme, apo në mbledhjet e ardhshme, sipas konsultimit tuaj reciprok me kërkesat që paraqisni, keni të drejtën për të ribërë edhe kërkesa të tjera lidhur me marrjen e informacionit. Kështu që, kjo konsiderohet si një çështje që është e drejtë ligjore dhe e pakufizuar për askënd.

Zoti Qefalia, fjala për ju.

**Xhemal Qefalia** - Unë nuk e quaj të rregullt që të kalohet nga mbledhja në mbledhje pa miratuar dhe pa mbyllur një mbledhje tjetër. Kështu që, kërkesa që me të drejtë nënkryetari i komisionit shtroi është nonsens. Duhet të kalohet në votim procesverbali i mbledhjes së kaluar. Ne nuk dimë se çfarë është bërë në mbledhjen e kaluar. Si mund t'i kalojmë në një mbledhje, apo t'i votojmë një herë në muaj këto procesverbale?! Kjo është shkelje, e cila nuk i jep vijueshmëri komisionit për të vazhduar.

Faleminderit!

**Enkelejd Alibeaj** –Të falënderoj, zoti Qefalia!

Unë ju thashë, ka një ngërç të vogël dhe po e marr unë përgjegjësinë në këtë rast, ajo që është një pengesë objektive e sekretarisë. Për dijeninë tuaj dhe të publikut, deri sot askush në këtë komision nuk ka marrë vendime në shkelje të ligjit, por janë vetëm kërkesa, të cilat janë paraqitur nga deputetët. Në mbledhjen e ardhshme do të merren vendime dhe, sigurisht, në atë mbledhje pikë e parë e rendit të ditës do të jetë domosdoshmërisht miratimi dhe votimi i procesverbaleve. Në këtë rast kërkoj dashamirësinë tuaj për vazhdimin.

Zoti Naço, fjala për ju.

**Nasip Naço** - Për procedurë.

Faleminderit, zoti Kryetar!

Unë jam shumë dashamirës, por, duke qenë se do të vazhdojmë te pika e tretë, që është vazhdimi i shqyrtimit të rregullores, pa ditur dhe pa e lexuar procesverbalin nuk i kam mundësitë, unë personalisht, që të hedh fall dhe të di se çfarë keni diskutuar ju dhe ne të gjithë në mbledhjen e kaluar. Pra, besoj se e keni futur komisionin në rreth vicioz.

Faleminderit!

**Enkelejd Alibeaj** - Po mundohem ta përsëris për të tretën herë: jo më kot e bëra këtë shpalosje të kërkesave, jo më kot sqarova, edhe në bazë të kërkesës Qefalia, që nuk ka, s'ka sesi të ketë, në fakt, asnjë lloj vendimmarrjeje, pra jemi thjesht dhe vetëm në konstatim veprimesh fizike. Nuk ka asnjë lloj vendimi, ka vetëm kërkesa, asgjë tjetër. Është e udhës ajo që ju thoni, që, me ezaurimin eventual të pikës së tretë, në mbledhjet e ardhshme kalojmë në proces vendimmarrjeje.

Po, zoti Naço.

**Nasip Naço** - Për të qenë edhe korrekt të gjitha palët, hiqeni nga rendi i ditës pikën 3, të vijë procesverbali dhe të vazhdojmë. Ju thoni: "Vazhdimi i shqyrtimit të rregullores së brendshme të funksionimit të komisionit" pa pasur procesverbalin, pa ditur nëse jemi te neni 1, 2, 17, 21 apo 19.

Faleminderit!

**Enkelejd Alibeaj** - Edhe një sqarim të fundit: jo më kot thashë që janë vetëm çështje kërkesash, jo vendimmarrjeje dhe, sigurisht, është e domosdoshme që të mos e heqim pikën 3 të rendit të ditës, që është shqyrtimit i rregullores së brendshme të funksionimit të komisionit hetimor, sepse është një nga pikat e ditës që duhet ta ezaurojmë dhe më pas ta hapim të gjithë veprimtarinë.

Zoti Bardhi, fjala për ju.

**Gazment Bardhi** - Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, do të duhet që në fillim të çdo mbledhjeje ne të miratojmë procesverbalin e mbledhjes paraardhëse, por kjo është një çështje që i përket dhe jemi të ndërvuar edhe nga administrata e Kuvendit. Për aq sa unë kujtoj nga veprimtaria e komisioneve hetimore, nuk më rezulton që ky rregull, pra i miratimit të procesverbalit të mbledhjes paraardhëse, të jetë bërë në

mbledhjet vijuese të komisioneve hetimore. Kjo për faktin se ata që zbardhin nuk i japin shumë përparësi veprimtarisë së komisioneve hetimore.

Së dyti, për t'u kthyer te thelbi i asaj që kërkon zoti Naço, duhet të jemi seriozë me njëri-tjetrin, sepse herën tjetër kërkuat, pa procesverbal, sepse nuk i kishim procesverbalet, as të herës së shkuar, që kryetari të fuste në rend dite vijimin e shqyrtimit të rregullores së brendshme të funksionimit të komisionit hetimor, ndërsa sot vini me kërkesë tjetër: të heqim nga rendi i ditës...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Në mbledhjen e kaluar, ku ju kërkuat që kjo të futej në rend dite, ne nuk e kemi shqyrtuar në mbledhjen e shkuar këtë pikë, sepse ju u larguat dhe ne nuk kishim çfarë të shqyrtonim, sepse shqyrtimi i rregullores kërkon votim dhe nuk kishte kuorum për çështje votimi. Pikat e rendit të ditës, si: vijimi i shqyrtimit të rregullores së brendshme të funksionimit të komisionit hetimor dhe zgjedhja e sekretarit të komisionit kanë qenë dy kërkesa të nënkryetarit të komisionit dhe të secilit prej anëtarëve kolegë të maxhorancës, që të futeshin dhe t'i shtoheshin rendit të ditës, të cilin e kishte propozuar kryetari në mbledhjen e shkuar, por sot keni një tjetër kërkesë. Kjo nuk më duket serioze, nuk ka asnjë lidhje, në gjykimin tim, fakti që administrata nuk ka bërë gati procesverbalet me vijimin normal të punës së komisionit. Me këtë rregullore nuk do të bëjmë ndonjë shpikje apo gjë të madhe, prandaj, ju lutem, kolegë, të çlirojmë veprimtarinë e komisionit, të vijojmë përpara me miratimin e rregullores, të vijojmë përpara me emërimin e sekretarit dhe të fillojmë punën, sepse kemi ngecur në një pikë që nuk përbën asnjë arsye të kemi ndasi me njëri-tjetrin. Te rregullorja e funksionimit të komisionit hetimor, a thua gjithë veprimtaria e komisionit do të varej nga kjo rregullore! Nuk varet nga rregullorja. Jua jam thënë dhe e kemi përsëritur disa herë që janë rregullore përgjithësisht të konsultuara, të miratuara me konsensus në një praktikë 20-vjeçare të parlamentit dhe marrim një rregullore. Unë kam nxjerrë dy rregullore nga protokollin e administratës, një me firmë të Taulant Ballës, kur ka qenë kryetar komisioni, dhe një me firmë të Edmond Spahos. Zgjidhni kë të doni nga këto të dyja, ta zbardhë administrata e Kuvendit, ta firmosim dhe të ecim përpara, se nuk është serioze, se kemi 6 mbledhje që merremi me nenin 1 dhe nenin 2 të rregullores së funksionimit të komisionit.

Kemi 6 mbledhje që duam të zgjedhim sekretarin dhe nuk e zgjedhim dot, a thua se këtu kemi ardhur për të pasur divergjenca me njëri-tjetrin!

Prandaj, ju ftoj me shumë sinqeritet, ju lutem, të ecim përpara me mirëkuptim, të paktën për këto dy pika!

Faleminderit!

**Enkelejd Alibeaj** – Faleminderit, zoti Bardhi!

Urdhëroni, zoti Naço!

**Nasip Naço** – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë jam serioz në ato që kërkoj dhe në atë që duhet të bëjmë. Ne kemi kërkuar që bashkërisht të votonim me konsensus dhe në parim ne e kemi miratuar rregulloren, pa diskutuar. Krahu andej e ka diskutuar në parim, a thua se do të bënte ndonjë shpikje!

Asnjë nga kolegët tanë nuk ka diskutuar, sepse ishim dakord në parim me një rregullore. Ramë dakord që ta fillonim diskutimin nen për nen. Propozimi ka qenë nga ana ime. Kam thënë që për ato nene, që në biem dakord, nga neni 1 deri te neni 24 dhe 25, hajdeni t'i kalojmë.

Për nenet e tjera, hajdeni t'i diskutojmë, nuk thamë t'i votojmë. Ne, bashkërisht, e votuam në parim. Kemi votuar bashkërisht deri te neni 4 dhe unë nuk e di çfarë ka ndodhur. Ne themi e kemi lënë deri te neni 4, ju thoni kemi vajtur te neni 17.

A ta lexojmë procesverbalin që të dimë nëse jemi te neni 4, apo te neni 17? Apo, ju, zoti kryetar, e keni tërhequr atë draft? Ose hidheni në votim, ta rrëzojmë dhe të fillojmë diskutimin nga ajo që thotë zoti Bardhi!

Meqë keni gabuar, hidheni në votim, ne ta rrëzojmë dhe të fillojmë nga e para me atë që thotë zoti Bardhi. Dakord, hajdeni t'i shikojmë. Edhe ne të lëshojmë, edhe ju të lëshoni! Konsensus kam kërkuar dhe kam thënë se, po t'u duhet dhe keni frikë se ne ju bllokojmë, votën time do ta keni. Atë e parashikon ligji. Cilat janë vendime të ndërmjetme? Atë kanë rregullore, atë kemi kërkuar edhe ne, por ne kemi kërkuar kohë të barabartë, zoti kryetar, se ju keni folur sa për të gjithë deputetët.

Këtë kemi kërkuar: që ti të jesh moderator, jo komentator. Ne kemi kërkuar që ti të mos kesh votë dyfishe, se nuk e ke, nuk e ka Kryetarja e Kuvendit; ne kemi kërkuar të zgjidhet sekretari, gjëra që i parashikon ligji, asgjë më shumë se ç'parashikon ligji. Sigurisht, do të ikim si dy drejtëza paralele, nuk do të ndërpritemi asnjëherë, pra kërkesat tuaja me kërkesat tona.

Ju keni humbur zgjedhjet dhe thoni na i vodhët, ne i kemi fituar. Jemi këtu dhe hajdeni t'ua tregojmë shqiptarëve, por KQZ-ja ka vendosur se kush i ka fituar dhe fakti që e keni pranuar

se jeni në opozitë... Hajdeni t'i diskutojmë, mbase u mbushet mendja dhe gjeni prova se vërtet jua paskemi vjedhur dhe nuk e dimë.

Faleminderit!

**Enkelejd Alibeaj** – Faleminderit, zoti Naço!

Të jap një sqarim, për të zbutur edhe tensionet e panevojshme.

Lidhur me procedurën, ju keni të drejtë për atë që ishte propozimi im i parë. E përsëris edhe për publikun që ramë dakord që në parim atë draft ta miratonim. Ndërkohë, nga neni 1- 4 është votuar, janë miratuar, neni 5 jo, nenet e tjera deri te neni 17 u miratuan dhe më pas jo, që do të thotë që, eventualisht, edhe miratimi në tërësi nuk ka ndodhur, që do të thotë se ajo pikë e rendit të ditës, sipas propozimit tim, ka rënë, nuk ka asnjë çudi...

**Nasip Naço** – Jemi të neni 17, apo te neni 4?

**Enkelejd Alibeaj** – Ta mbaroj. Ka rënë në tërësi, zoti Naço. Në momentin kur nuk votohet në tërësi, e dimë të gjithë që bie, kështu që ka rënë për këtë pikë.

*(Diskutime në sallë.)*

Ju lutem, ka rënë. Zoti Naço, mua nuk më vjen turp për asgjë, sepse bëra detyrën time, u mundova të bëja detyrën time. Nuk i mori votat, ka rënë dhe nuk ndihem fare i turpëruar në këtë pikë, për sa kohë që ka rënë ajo pikë e rendit të ditës. Sigurisht, ne jemi drejtëza paralele dhe nuk kemi të prerë. Absolutisht, pretendimet janë ato që ju thoni.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Të lutem, ta them deri në fund edhe për publikun, të mos e bëjmë dialog. Ta mbaroj, sepse ne kemi detyrimin të sqarojmë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Zoti Xhaferraj, ju lutem, nuk ta dhashë fjalën, fike, më lër të bëj detyrën...

Në kemi detyrimin të sqarojmë publikun, pa e kthyer në një debat me njëri-tjetrin. Pra, ajo pikë e rendit të ditës ka rënë. Qëndrimet tona janë këto që janë. Është e drejtë ajo që thoni ju që secila palë, secili deputet pretendimet, që ka ngritur, do të duhet t'i verifikojë dhe fundi do të tregojë dhe nuk kemi asnjë lloj dyshimi për këtë pikë.

Lidhur me pikën 3 të rendit të ditës, ajo është si pikë e rendit të ditës, s'ka se si të mos jetë: shqyrtimi dhe miratimi i rregullores, po kështu edhe pika 4 e rendit të ditës.

Urdhëroni, zoti Naço!

**Nasip Naço** – Zoti kryetar, draftin që keni paraqitur ju, hidheni në votim ta rrëzojmë dhe të vazhdojmë me amendamentet apo propozimet e zotit Bardhi. Pranojeni që keni gabuar, ta hedhim në votim dhe kaq.

**Enkelejd Alibeaj** – Ka rënë.

Edhe një sqarim, ju lutem, zotërinj!

Zoti Naço, nuk i takon as sinqeritetit të kësaj që ta hedhim në votim dhe ta rrëzojmë. Po bëj një gjë tjetër: e tërheq. Meqë unë jam propozuesi, e tërheq dhe kështu lëmë hapësirë e tillë që ta fillojmë edhe një herë, sipas një propozimi të bërë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Ju lutem, kolegë! Do t'ju jap edhe juve fjalën.

Bëjmë këtë gjë: përderisa nuk mori votë, unë e tërheq. Tentova, u mundova, bëmë përpjekje për të rënë dakord, unë e tërheq. Jemi në pikën për ta rihartuar, pikën zero.

Zoti Xhaferraj, tani e keni fjalën!

**Ferdinant Xhaferraj** – Faleminderit, zoti kryetar!

Shumë mirë që ofruat edhe konsensusin e fundit. Por më vjen keq që duhet t'ju kujtoj se duhet të jenë më korrekt në drejtimin e komisionit. Ka filluar mbledhja në orën 10:00, është ora 11:00 dhe nga kolegët e opozitës ka folur 3 minuta vetëm zoti Gazment Bardhi. Për 1 orë ka folur 3 minuta vetëm zoti Gazment Bardhi. Do t'ju lutesha! Ky është fakt!

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Kemi 1 orë që kemi folur, jemi 4 kolegë dhe ka folur 3 minuta vetëm zoti Bardhi.

E dyta, do t'ju lutesha zotit Naço, kujdes me komentet, të mos i paragjykojë gjërat. Po, ne e kemi pranuar që jemi në opozitë. Ju keni fituar, por në këtë komision kemi objektiv të hetojmë si keni fituar ju dhe pse jemi ne në opozitë. Nuk kuptoj një gjë: u bënë disa mbledhje rresht për çfarë keni frikë? Ju keni shtet, ju keni pushtet, ju keni institucione, keni institucionet lokale, pse doni të na pengoni që të shkojmë t'ju pyesim? Çfarë frike keni ju që keni fituar dhe i keni të gjitha?! Nuk e kuptoj!

**Enkelejd Alibeaj** – Të nderuar kolegë!

Ne jemi pothuajse në fazat fillestare të komisionit hetimor. E kemi të qartë qëndrimin e secilës palë, as nuk shtojmë, as nuk ndryshojmë. Talenti, aftësia, mundësia, kapaciteti për të provuar pretendimet e secilës palë ne atë çfarë themi, pala tjetër atë çfarë pretendon, qëndron te



fakti sa do të kemi mundësi për të sjellë prova që të bindim jo vetëm veten, por, mbi të gjitha, publikun. Retorika, besoj se nuk nxjerr diçka më tepër sesa kaq, prandaj...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Zoti Koçi, ta mbaroj!

Unë ju thashë se atakohem edhe andej, edhe këtej.

Kalojmë te pika e tretë e rendit të ditës.

Zoti Koçi, me gjithë qortimin që do të marr nga pala tjetër se po favorizoj maxhorancën, keni fjalën.

**Petro Koçi** – Përderisa të gjithë kemi informacion se ka një konsensus lidhur me procedimin e mbledhjes, mendoj se zgjidhja është shumë e thjeshtë. Te pika 3 e rendit të ditës hiqet fjala “vazhdimi” dhe të zëvendësohet me “shqyrtimi” dhe mbaron.

**Enkelejd Alibeaj** – Propozimi i zotit Koçi: të hiqet fjala “vazhdimi” dhe fillon fjalia: “Shqyrtimi i rregullores së brendshme të funksionimit të komisionit hetimor”. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Zoti Vasili, ndjesë. Keni të drejtën për të folur. Kjo është një çështje që besoj se kemi rënë dakord.

Urdhëroni!

**Petrit Vasili** – Durimin e çuat në maksimum.

Pyetja është kjo që t’i kemi shumë të qarta, meqenëse i verbalizoni: me demek, edhe miratimi në parim, nuk qëndron? Ky është moment për t’u sqaruar, se ky që u bë pazari i gjësë, është pazari i gjësë. Kush do, le ta bëjë, se atë nivel ka. Është votimi në parim, ku janë ngritur duart e të gjithëve?! Po, jo. Nëse është votuar në parim, ky është vazhdim. Nuk mund të jetë mosvazhdim. Në rast se ka rënë ai votim në parim, unë po ngrihem dhe po iki, në kuptimin e mirë të fjalës, jo të keq të saj, se nuk kemi çfarë të bëjmë.

**Enkelejd Alibeaj** – Nëse keni qenë i vëmendshëm, unë bëra një gjest që nuk është aspak kalorësiak, por në këtë rast po e konsideroj si një mundësi të mirë për të shkuar drejt konsensusit.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Ju lutem! Absolutisht, është e vërtetë! Dëgjoni sqarimin!

Ka qenë votimi në parim, ka qenë unanim, po, sigurisht, pastaj votimi nen për nen, siç u bë i ditur tashmë, se nuk ngeli i madh e i vogël pa e marrë vesh, nuk shkoi deri në fund.

Atëherë, për ta zgjidhur ngërçin, meqenëse ishte propozim i bërë nga kryetari dhe për ta rikthyer, siç tha zoti Kollçaku, në pikën zero, e tërheq unë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Të lutem! Dakord, zoti Vasili. Unë besoj që gjeste kalorësiake na duhet të bëjmë gjithsecili...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Të jap sqarimin që të mos e bëjmë dialog!

**Petrit Vasili** – Nuk jemi këtu për të akomoduar psikopati. Në po themi: votim në parim dhe 4 nene... Dakord, mund të ketë debat, kanë pasur dakordësi, ec më tutje nga ajo pikë!

**Enkelejd Alibeaj** – Dakord!

**Petrit Vasili** – Kemi frikë nga kjo?

**Enkelejd Alibeaj** – Jo!

**Petrit Vasili** – Atëherë, nëse kemi frikë, kot që vazhdojmë, me frikë nuk mund të drejtohet kjo.

**Enkelejd Alibeaj** – Nuk ka lidhje as me frikën, ka lidhje me eksplorimin e mundësive për të gjetur një gjuhë të përbashkët.

*(Zoti Vasili flet pa mikrofon.)*

Pikërisht, për këtë arsye për të hequr çfarëdolloj grimce të vogël skepticizmi, unë bërë atë akt, meqenëse ishte një gjest i bërë nga ana ime, si propozim.

Kalojmë në pikën 3, gjithmonë me fjalinë: “Shqyrtimi i rregullores së brendshme të funksionimit të komisionit hetimor”.

Zoti Gogu, a keni për të thënë diçka?

**Toni Gogu** – Kam diçka. Nisur nga diskutimet që kanë ndodhur në mbledhjet e kaluara për shqetësimin tuaj për të drejtën e opozitës për të kërkuar shkresa, informacion zyrtar, dëshmi të caktuara, të cilat duhej të kalonin pa votim, në zbatim të ligjit “Për komisionet hetimore” dhe kërkesës sonë që plani paraprak i hetimit, si një tërësi veprimesh procedurale, të miratohet me një vendim të ndërmjetëm të komisionit, jemi plotësisht dakord që rregulloret e mëparshme të Kuvendit, të cilat e kanë drejtpeshuar këtë mekanizëm hetues të komisionit, të mund të vazhdojmë me shqyrtimit e njëres prej tyre.

Meqenëse ju bëtë një xhest kalorësiak dhe një provë të drejtimit të matur, ne jemi plotësisht dakord që të marrim në shqyrtim atë rregullore që ka firmosur zoti Spaho.

**Enkelejd Alibeaj** - Faleminderit, zoti Gogu!

Për sqarimin tuaj, e tha edhe zoti Bardhi, e përmendi edhe zoti Gogu, në traditën më të mirë të komisioneve hetimore parlamentare, gjë të cilën e kemi artikuluar edhe në mbledhjet e mëparshme, kemi arritur në një diskutim me zotin Gogu që të operojmë në këtë mënyrë: të qëmtojmë në komisionet e mëparshme aktet me të cilat janë miratuar rregulloret e atyre komisioneve, për të hequr çfarëdolloj dyshimi për futje rregullash rishtazi, të cilat për këdo mund të ngrinin hije skepticizmi.

Meqenëse tradita parlamentare e komisioneve hetimore është e pasur, kemi arritur në një gjuhë të përbashkët që, për të paktën dy komisionet e fundit hetimore të parlamentit, ngritur në vitin 2016 (meqë ra fjala, thjesht për të kujtuar publikun dhe medien, edhe kolegët në këtë rast, të cilët e kanë konsultuar), të cilët i referoheshin veprimtarisë hetimore, ku njëri ishte për privatizimet e CEZ-it, ndërsa tjetri kishte lidhje përsëri me CEZ-in, nëse ju kujtohet. Këto komisione hetimore, njëri drejtohej nga zoti Spaho, tjetri drejtohej nga zoti Balla, kanë qenë në të njëjtën kohë dhe kanë miratuar rregulloret respektive. Nuk është aspak habi, që të dyja këto rregullore janë të njëjta deri në germë e në presje.

Besoje se është e udhës që si set rregullash për rregulloren të marrim njërën prej tyre, pasi janë identike, nuk ndryshojnë as njëra, as tjetra.

Unë e pranoj, po, kjo është një mënyrë për të vepruar, në mënyrë që të gjejmë rregulla të tilla, të cilat ruajnë autoritetin e ligjit, plotësojnë rregullat e brendshme administrative, kanë qenë të miratuara me konsensus dikur mes palëve të atyre komisioneve, që janë edhe palët e këtyre komisioneve. Për këtë arsye biem dakord që njërën prej këtyre dy rregulloreve (zoti Gogu ju thatë për njërën prej rregulloreve të komisionit, që janë identike si ajo e zotit Spaho, ashtu edhe ajo e zotit Balla). Kështu që do të administrohen dhe zbardhen nga ana e sekretarisë sipas tekstit që është administruar.

Për këtë arsye, duke qenë se ju, kolegë, jeni të konsultuar me të, po i ndjekim strikt po sipas procedurës, për të mos pasur askush dyshime në mbledhjet e ardhshme, por edhe për komisionet e tjera hetimore në vazhdim, që eventualisht do të ngrihen, të shërbejë si një shembull i mirë ,që edhe rregulloret, miratimi i tyre, edhe për ato komisione të konsiderohet si një...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Më lejoni ta mbaroj, zoti Naço!

Të respektojmë procedurën duke filluar edhe një herë me miratimin në parim, nen për nen dhe në tërësi. Nëse jeni dakord, mund të operojmë në këtë mënyrë.

Po, zoti Naço.

**Nasip Naço** – Faleminderit, zoti kryetar!

Konsensusi është dhënë edhe nga ana jonë që në parim, po ta hidhni në votim, ne do ta votojmë, ndërsa për të vazhduar nen për nen, do të donim një draft të ngjashëm që ta kemi në tavolinë. Të bëjmë 5 minua pushim, të na vijë drafti dhe ta gjykojmë.

Faleminderit!

**Enkelejd Alibeaj** – Ta hedhim në votim në parim.

**Toni Gogu** - Jemi dakord me propozimin tuaj, që të vazhdojmë me mënyrën e votimit siç e parashikon Rregullorja e Kuvendit.

**Enkelejd Alibeaj** – Dakord.

Ecim me votimin në parim dhe pastaj nen për nen.

Zoti Naço, përmbajtja kjo është dhe ju e keni para. Do të zbardhet nga sekretaria.

Kush është dakord me miratimin në parim të rregullores, sipas shpjegimit që bëra?

Të gjithë pro, asnjë kundër.

Miratohet.

Mund të ecim nen për nen?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jeni dakord të bëjmë 5 minuta pushim?

Zoti Salianji.

**Ervin Salianji** – Të flasim për propozimin që kemi, sepse kjo nuk është një çështje që kalon mes nesh me cicmice, është një diskutim që po e ndjek i gjithë opinioni publik për një shqetësim madhor që kanë shqiptarët për vjedhjen e zgjedhjeve. Unë nuk di, por edhe kolegët përballë, që kanë qenë në profesion prokurorë, zoti Naço që ndonjë hajdut të pranojë që është i tillë. Hajduti kapet. Përpyekja për të shkuar te kjo, pa diskutim do të hasë në pengesa dhe pengesa të dokumentuara qartë dhe të para nga publiku në 5 mbledhje përpara, të cilat tentohen të bëhen edhe sot. Duhet ta themi këtë para se të mbetemi në cicmice të vogla procedurale, të cilat zgjidhen në sekondë. Jua ofruam herën e parë që të propozoni çfarë të doni, po e themi prapë sot të njëjtën gjë, ju kërkoni 5 minuta pushim. Mund të bëjmë 5 minuta pushim, por pas 5-minutëshit

të njëjtën gjë do të thoni përsëri, do të dilni jashtë dhe do t'ju japë urdhër ai tjetri e do të dilni prapë, kështu që vazhdojmë.

**Enkelejd Alibeaj** – Zoti Gogu.

**Toni Gogu** - Kemi hyrë në një proces votimi dhe çeljen e diskutimeve, të cilat nuk i shërbejnë procesit të votimit mendoj t'i shtyni në një moment të dytë, për shkak se, paralajmëroj, mund ta nxjerrin mbledhjen nga shinat e rendit të ditës.

**Enkelejd Alibeaj** – Kjo kërkesë pranohet.

Është e udhës që, përderisa ne na duhet që për rregulloren të gjejmë gjuhën e përbashkët, secila palë të eksplorojë mundësitë, ne bëmë tonën, pashë vullnetin e mirë nga zoti Gogu që ta miratojmë rregulloren me konsensus, sipas varianteve të mëparshme të miratuara, kështu që ka një kërkesë për 5 minuta pushim.

Dakord, bëjmë 5 minuta pushim.

Meqenëse zoti Kollçaku erdhi, ne mund ta vazhdojmë.

Atëherë, ndihma është thjesht të kalojmë të nenet.

Zoti Naço.

**Nasip Naço** – Faleminderit, zoti kryetar!

Ne kemi marrë një model të ngjashëm. Në parim e votuam të gjithë, por te neni 1 flitet për CEZ-in, prandaj kërkova 5 minuta pushim që të draftohet një material, që të dimë çfarë votojmë, që të mos gabojmë, siç gabuat i herën e kaluar, për vendimin nr. 66 të vitit 2016.

**Enkelejd Alibeaj** – Zoti Naço, është shumë e drejtë ajo që ju thatë. Unë e sqarova : këto rregulla do t'i miratojmë nen për nen dhe për të gjitha saktësimet teknike për shkakun e vetëm sepse ne kemi huazuar nga komisionet e mëparshme, të qartësohen në zbardhjen e rregulloreve prej sekretariatit.

Kjo është një gjë e thjeshtë.

Po, zonja Gjylameti.

**Blerina Gjylameti** - Pa pasur nevojë që të presim derisa të saktësojë gjithë stafi i Kuvendit, ato që na asistojnë, gjatë kohës që hidhet në votim ju mund ta saktësoni me zë duke thënë: “Me ndryshimet përkatëse” me qëllim që të vijojmë.

**Enkelejd Alibeaj** – Pranohet kërkesa e zonjës Gjylameti, që në citimin e neneve përkatëse...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Doni pushim?

Pesë minuta pushim.

Kolegë, rifillojmë mbledhjen.

Nëse ka medie jashtë, le të vijnë!

Rifillojmë mbledhjen në atë pikë ku e lamë për të bërë 5 minuta pushim. Ndërkohë, unë së bashku me asistencën e sekretarisë kam identifikuar ndryshimet eventuale që pëson rregullorja e marrë më parë. Për dijeninë tuaj janë vetëm 4 ndryshime: njëri qëndron në titull, tjetri në nenin 1, në nenin 4 dhe tjetri në nenin 21, ndërsa të tjerat janë njësoj. Për efekt të zbardhjes, në kalimin në çdo nen të rregullores do t'i citoj ndryshimet, që edhe sekretaria ta ketë të thjeshtë në zbardhjen e saj.

Ndryshimi i parë i përket titullit të rregullores. Rregullorja do të ketë këtë përmbajtje: “Rregullore e brendshme e komisionit hetimor” dhe ndryshimi qëndron në vendosjen e titullit të vendimit të komisionit të Kuvendit, të miratuar me vendim nr. 79, datë 14.10.2021 “Për ngritjen e komisionit hetimor të Kuvendit për kontrollin e veprimtarisë së organeve të administratës publike dhe pushtetit vendor për të verifikuar përdorimin e burimeve të administratës shtetërore për qëllime elektorale në zgjedhjet e 25 prillit 2021”. Ky është titulli që do të ketë edhe rregullorja.

Kush është dakord?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Unë e lexova: Rregullore e brendshme e komisionit hetimor, miratuar me vendim, numër, datë dhe titulli që sapa e citova.

Atëherë, për t'i qëndruar strikt çfarë është miratuar më parë ne duhet t'i qëndrojmë strikt kësaj.

Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Në nenin 1 duhet të bëjmë një ndryshim, që i referohet përsëri titullit. Titulli është ky: “Për ngritjen e komisionit hetimor të Kuvendit “Për kontrollin e veprimtarisë së organeve të administratës publike dhe të pushtetit vendor për të verifikuar përdorimin e burimeve të administratës shtetërore për qëllime elektorale në zgjedhjet e 25 prillit 2021””. Ky është ndryshimi parë.

Ndryshimi i dytë, në nenin 1, të Rregullores së mëparshme numri i anëtarëve të komisionit hetimor ka qenë 11, me vendimin e Kuvendit jemi 15, që do të thotë që edhe shifra 11 do të ndryshohet në 15. Këto janë dy ndryshimet e nenit 1, ndërsa pjesa tjetër ngelet njësoj.

*(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)*

Sigurisht, edhe numri i vendimit.

Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2 “Objekti. Nuk ka asnjë ndryshim.

Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 3 “Baza ligjore”. Nuk kam identifikuar asnjë ndryshim, ngelet ai që është në variantin që e bëmë të qartë.

Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 4. Kam identifikuar një ndryshim për sa i përket numrit të vendimit të Kuvendit. Ka qenë me nr. 89, datë 22.10.2015 dhe duhet bërë nr. 79/2021, datë 14.10.2021. Ky është ndryshimi i vetëm, ndërsa pjesa tjetër është e njëjtë.

Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 5. Nuk kam identifikuar asnjë ndryshim ngelet ajo përmbajtje që është.

Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 6 “Detyrat e sekretarit”. Edhe në këtë nen nuk kam identifikuar asnjë ndryshim.

Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 7 “Zhvillimi i mbledhjeve të komisionit”. Nuk kam identifikuar asnjë lloj ndryshimi.

Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 8. Nuk kam identifikuar asnjë ndryshim dhe ngelet përmbajtja e të mëparshmes.

Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 9 “Projektvendimet”. Nuk kam identifikuar asnjë ndryshim.

Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 10 “Propozimet”. Nuk kam identifikuar asnjë ndryshim, pra mbetet e njëjta përmbajtje si e rregullores së mëparshme.

Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 11 “Radha e votimit”. Edhe për këtë nen nuk kam identifikuar asnjë ndryshim ngelet po ajo përmbajtje.

Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 12 “Mënyra e votimit”. Nuk kam identifikuar asnjë ndryshim.

Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 13 “Procesverbali i mbledhjeve”. Nuk kam identifikuar asnjë ndryshim.

Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 14 “Kërkimi i të dhënave”. Nuk kam identifikuar asnjë ndryshim.

Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 15 “Ekspertimi dhe caktimi i ekspertëve”. Nuk kam identifikuar asnjë ndryshim.

Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 16 “Aktivizimi i specialistëve të jashtëm”. Nuk kam identifikuar asnjë ndryshim.

Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 17 “Thirrja për të dëshmuar”. Nuk kam identifikuar asnjë ndryshim.

Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 18. Nuk kam identifikuar asnjë ndryshim.



Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 19 “Pjesëmarrja e anëtarëve të komisionit në seancë dëgjimore”. Nuk kam identifikuar asnjë ndryshim, mbetet përmbajtja e rregulloreve të mëparshme.

Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 20 “Rithirja e personave për t’u dëgjuar në seancë”. Nuk kam identifikuar asnjë ndryshim, mbetet ajo përmbajtje.

Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 21. Në këtë nen kam identifikuar një ndryshim të thjeshtë dhe teknik. Në vend të numrit të vendimit të Kuvendit, që kishte ngritur atë komision, do të duhet ndryshuar me numrin dhe datën e vendimit të Kuvendit për këtë komision.

Pra, nga numri 89/2015 të vendoset numri 79, që është numri i vendimit të Kuvendit, viti 2021 dhe data 14.10.2021. Nuk ka ndryshime të tjera.

Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 22 “Raporti përfundimtar”. Nuk kam identifikuar asnjë ndryshim.

Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 23 “Buxheti i komisionit” Nuk kam identifikuar asnjë ndryshim.

Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 24 “Hyrja në fuqi dhe afati”. Nuk kam identifikuar asnjë ndryshim.

Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Kush është pro versionit me ndryshimet teknike që unë bëra? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kështu përfundon edhe saga e Rregullores, duke miratuar një rregullore për funksionimin e këtij komisioni, siç edhe ka qenë në komisionet e tjera hetimore.

Kjo pikë e rendit të ditës konsiderohet e ezauruar.

Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës, “Emërimi i sekretarit të komisionit”, i cili është detyrim tashmë jo vetëm i ligjit, por edhe i Rregullores që sapo miratuam.

A ka ndonjë propozim nga kolegët?

Zoti Gogu.

**Toni Gogu** – Faleminderit, zoti kryetar!

Ne propozojmë zotin Klevis Xhoxhi, anëtar i këtij komisioni për të shërbyer në detyrën e sekretarit të komisionit.

**Enkelejd Alibeaj** – Është e udhës që sekretari t’i takojë pjesës së shumicës, siç ka ndodhur edhe në raste të tjera.

Për këtë arsye hedh në votim propozimin e bërë nga zëvendëskryetari, zoti Gogu, që sekretar i komisionit hetimor, i ngritur me rastin e hetimit të zgjedhjeve të 25 prillit, të jetë zoti Klevis Xhoxhi, anëtar i komisionit hetimor.

Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Emërohet sekretar i komisionit zoti Klevis Xhoxhi.

Urime, zoti Xhoxhi!

Pika e fundit e rendit të ditës është...

**Xhemal Qefalia** – Unë kam votuar kundër, a mund ta shpjegoj votën time?

**Enkelejd Alibeaj** – Kundër zotit Xhoxhi? Nuk ka mundësi.

**Xhemal Qefalia** – Votova kundër për të marrë fjalën. Ne po biem në kundërshtim me atë që miratuam, sepse, sipas rregullores që miratuam, duhet të ishte bërë që në mbledhjen e parë, prandaj ta quajmë këtë mbledhjen e parë.

**Enkelejd Alibeaj** – Jo, ky është vijim i mbledhjes së parë, zoti Qefalia, dhe ju si deputet i vjetër e dini këtë gjë. Pastaj më mirë vonë se kurrë.

Të kalojmë te pika e fundit e rendit të ditës, që është caktimi i ditës dhe orës për mbledhjen e radhës. Kemi fatin të kemi prezent edhe kryetarët respektivë të Komisionit të Ligjeve dhe të Komisionit të Sigurisë për të mos pasur përplasje.

Zoti Gogu, ju mund të konsultoheni me kolegët tuaj dhe të propozoni një ditë.

Po, edhe ju.

Fjalën e ka zonja Gjylameti.

**Blerina Gjylameti** – Faleminderit, kryetar!

Për sa i përket organizimit të mbledhjeve, datave dhe orarit të mbledhjeve në vijim, meqenëse jemi në periudhën që në Kuvend po diskutohet buxheti dhe jo vetëm në komisionet ku kemi kryetarët përkatës, por në mënyrë të posaçme në Komisionin e Ekonomisë dhe të Financave, ku unë dhe një pjesë e kolegëve bëjmë pjesë, duhet të kemi parasysh që mbledhjet e komisioneve për shqyrtimin e projektbuxhetit fillojnë nga ora 9:00 e mëngjesit dhe përfundojnë diku nga 16:00 ose 17:00. Unë sugjeroj që si orar për mbledhjet tona të jetë ora 17:00, në mënyrë që mbledhjet të kenë përfunduar dhe të mos kemi problematikën e kuorumit në këtë komision.

**Enkelejd Alibeaj** – Po, koleg.

**Gazment Bardhi** – Jam dakord me orën 17:00. Ndërkohë, ne do të procedojmë me kërkesat që ju lexuat sot dhe do të jemi në pritje që secili prej anëtarëve të komisionit të paraqesë kërkesat për të dhënat, sepse në këtë fazë jemi të mbledhja e të dhënave.

**Enkelejd Alibeaj** – Për sqarim, pranohet sugjerimi i zonjës Gjylameti, për faktin që Kuvendi ndodhet në një periudhë të ngarkuar...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Xhaferraj, të lutem, se nuk ta kam dhënë fjalën. Atëherë, orari i mbledhjeve eventuale të komisionit do të jetë ora 17:00, me arsyetimin që tha zonja Gjylameti, për shkak se Kuvendi dhe komisionet janë të ngarkuara.

Së dyti, për faktin se deri në datën 14 nëntor, që do të jetë edhe data e miratimit të planit të hetimit, mbledhjet eventuale do të jenë thjesht dhe vetëm për shpалosjen e kërkesave për marrjen e të dhënave dhe informacioneve tek institucionet zyrtare, siç bëra në këtë rast, meqenëse sot paraqita kërkesat e depozituara prej jush.

Zoti Gogu, cila është dita, sepse për orarin ramë dakord, e parë që edhe ju të paraqisni kërkesat për të marrë të dhënat dhe informacione lidhur me objektin e hetimit?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Vasili, të lutem!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Të lutem, nuk po them këtë gjë, por për t'ju dhënë mundësi edhe kolegëve të tjerë që të paraqesin dhe të depozitojnë kërkesat për informacione...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Atëherë, ora është mirë të jetë, që të mos kemi përplasje, ndërsa dita ka sens të caktohet.

Zoti Gogu, a keni ndonjë propozim?

**Toni Gogu** – Propozimi...

**Enkelejd Alibeaj** – Më fal, zoti Gogu, ne mund ta zgjidhim, por është detyrim i ligjit dhe i rregullores që në fund të mbledhjes si pikë e fundit të jetë caktimi i mbledhjes së radhës.

Fjala për ju zoti Gogu.

**Toni Gogu** – Ne propozojmë që, në zbatim të atij vendimi që morëm për orën, në lidhje me ditën, të konsultohemi me kalendarin e punimeve të Kuvendit për të gjetur ditën e përshtatshme dhe t'ua komunikojmë kolegëve, përveç të shtunës dhe të dielës.

**Enkelejd Alibeaj** – Dakord.

Po, zoti Vasili.

**Petrit Vasili** – Tani, gjëra të tilla nuk kanë ndodhur ndonjëherë. Biem dakord për orën, por nuk kemi ditën. Mbledhja ka edhe ditë, edhe orë. Ta lëmë historinë e orës, sepse është muhabet kot. Kemi një orientim, që mund të mblidhemi edhe pasdite, që nuk është ndonjë problem, por ta lëmë të hapur, sepse kur nuk kemi ditën nuk kemi pse të lëmë orën. Pra, ta lëmë të hapur.

**Enkelejd Alibeaj** – Një propozim që t'i përmbledhë të gjitha kërkesat është ky: ne, në cilësinë e kryetarit dhe të zëvendëskryetarit dhe të sekretarit të biem dakord me fleksibilitet, duke përjashtuar të shtunën dhe të dielën, ora si parim është ajo që tha zonja Gjylameti, por nëse do të gjejmë dritare të tjera për ta bërë efektive mbledhjen, në konsultim me zëvendëskryetarin dhe sekretarin të caktojmë ditën dhe orën, por duke respektuar rregullin e ligjit dhe të rregullores për të njoftuar së paku 48 orë më parë. Pra deri të hënën, unë me zotin Gogu dhe zotin Xhoxhi, besoj se do ta kemi caktuar mbledhjen e radhës.

Këtu mbyllet mbledhja. Punë të mbarë!

Faleminderit!

## **MBYLLET MBLEDHJA**